



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:106094

Datë: 21.01.2021

Numri i dokumentit: 01427488

C.nr.890/2020

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari Individual Naim Mehollu, në çështjen juridike të paditësit: A.L nga Mitrovica, të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. L.A nga Mitrovica, kundër të paditurës: S... me seli në Mitrovicë, për shkak të kompensimit të ardhurave në emër të shpërblimit jubilar, pas mbajtjes së seancës kryesore publike me dt. 15.01.2021 në prezencë të autorizuarit të paditësit dhe përfaqësueses së të paditurës, me dt. 21.01.2021 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

OBLIGOHET e paditura S... me seli në Mitrovicë t'ia paguajë paditësit A.L nga Mitrovica, në emër të shpërblimit jubilar për periudhën e punës për më shumë se 20 vite të përvojës së punës në vlerë të (1) page bazë, shumën prej 465.41 €, (Katërqind e gjashtëdhjetë e pesë euro e dyzet e një cent), të gjitha në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

OBLIGOHET e paditura S... me seli në Mitrovicë t'ia paguajnë paditësit shpenzimet e procedurës në shumë totale prej 198 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, me datën 01.09.2020 ka ushtruar padi e te precizuar për kompensimin të 1 page në emër të shpërblimit jubilar, duke u bazuar në nenin 17 par. 3 nën par. 3.1 të Kontratës Kolektive Sektoriale të miratuar në muajin Qershor 2018, po ashtu edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata, me dt.15.01.2021, ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësit, dhe përfaqësuesja e të paditurës.

I autorizuar i paditësi në seancë e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se: Mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së parashtruar, gjykatën e njoftojmë se paditësi e ka realizuar shpërblimin jubilar për dhjet vite te përvojës se punës, e pas kësaj kërkojmë për 20 vite te përvojës se punës një pagë jubilarë ashtu qe bej precizimin e padis dhe atë për 20 vite te përvojës se punës kërkojmë një pagë jubilarë në vlerë prej 465.41 €, kurse heqim dorë nga kamata ligjore. Shpenzimet e procedurës kontestimore i kërkoj sipas tarifës se avokatëve.

Përfaqësuesja e të paditurës në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se: Nuk e kontestoj bazën juridike të padisë, menaxhimet e spitalit e ka refuzuar kërkesën e paditësit në mungesë të mjeteve buxhetore, nuk e kontestoj lartësinë e pagës e as përvojën e punës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 të LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Kërkesa drejtuar të paditurës e dt. 14.07.2020, Vërtitimi i lëshuar nga e paditura me dt. 05.02.2020, Kontrata e punës e dt. 28.12.2012, Aktgjykimi C.nr.700/2019 i dt. 05.03.2020, Lista e pagës e dt. 28.10.2020 dhe pas shqyrtimit bashkërisht të të gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Faktet jo kontestuese:

Gjykata fillimisht sqaron faktin se paditësi e ka realizuar një pagë bazë në emër të shpërblimit jubilar për dhjet vite të përvojës së punës, ky fakt vërtetohet në bazë të aktgjykimit C.nr.700/2019 i dt. 05.03.2020 i cili gjendet në shkresë të lëndës, ndërsa në rastin konkret pasi që i ka mbushur 20 vite të përvojës së punës e kërkon edhe një pagë bazë.

Paditësi para ngritjes së padisë ju ka drejtuar të paditurës me kërkesë të dt. 14.07.2020 për kompensimin e pagave jubilarë, mirëpo nga deklaratimet e të autorizuarës të paditurës për gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se e njëjta ju ka refuzuar.

Nuk është kontestues fakti që paditësi ka qenë në marrëdhënie pune të e paditura nga data 01.10.1999, ky fakt vërtetohet nga Vërtetimi mbi përvojën e punës së paditësit lëshuar nga e paditura dt.05.02.2020.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës bazë që paditësi e ka realizuar nga e paditura është shuma mujore prej 465.41 €, ku kjo vërtetohet nga Pasqyra e pagës në emër të paditësit e dt.01.10.2020 lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, po ashtu këtë fakt nuk e konteston as e paditura në seancën e shqyrtimit kryesor.

Nuk është kontestues fakti që paditësi është duke e vazhduar punën tek e paditura, ky fakt vërtetohet nga Vërtetimi mbi përvojën e punës së paditësit lëshuar nga e paditura dt.05.02.2020.

I pa kontestueshëm mbetet fakti se paditësi e ka realizuar një pagë bazë në emër të shpërblimit jubilar për dhjet vite të përvojës së punës, ky fakt vërtetohet në bazë të aktgjykimit C.nr.700/2019 i dt. 05.03.2020 i cili gjendet në shkresë të lëndës.

Lidhur me pretendimet e të autorizuarës së të paditurës duke e kontestuar padinë si pasojë e mjeteve buxhetore, pretendimin e lartëcekur gjykata e refuzoj si të pa bazuar, dhe atë duke u bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të miratuar në dt. 11.06.2018, andaj për vendosje sipas pikës I të dispozitivit sa i përket pagesës së një page në emër të shpërblimit jubilar iu referua nenit 17 par. 3 nën par. 3.1 të kontratës së lartëcekur me të cilën parashihet se “Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij”, e në rastin konkret paditësi është i punësuar ende të e paditura për më shumë se 20 vite.

Bazuar në nenin 17 par.4 Kontratën Kolektive Sektoriale është detyrim i punëdhënësit të fundit këtu të paditurës që t'i paguaj kompensimin për kategorinë e lartëcekur.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve 20 € në emër të taksës për padi, 78 € për përpilimin e padisë për paditësin, dhe 100 € për përfaqësim për një seancë gjyqësore apo shumen e përgjithshme prej 198 €, të gjitha këto në afat 7 ditor nga pranimi i aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par. 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.890/2020, datë 21.01.2021

GJYQTARI
Naim Mehulli

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimin të të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2020:106094
Datë: 21.01.2021
Numri i dokumentit: 01427488